



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË
KOMISIONI I ZHVILLIMIT TË KARRIERËS**

OPINION MBI KANDIDATIN MIRELA KAPO

Këshilli i Lartë i Prokurorisë, mbështetur në nenet 53/2, 54 dhe 55 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, më datë 01.02.2020 ka shpallur hapjen e procedurës për paraqitjen e kërkesës nga kandidaturat që vijnë nga radhët e prokurorëve, për t’u komanduar, me pëlqimin e tyre, për:

Magjistrat pranë zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Afati i paraqitjes së kërkesave për komandim është përcaktuar 2 (dy) javë nga dita e shpalljes së vendimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë. Brenda afatit të caktuar për paraqitjen e kërkesave për komandim, pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë është paraqitur nje kërkesë nga znj Mirela Kapo prokurore pranë prokurorisë Krujë:

Në datë 12.02.2020 pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë është protokolluar kërkesa e prokurores znj. Kapo, e cila ushtron funksionin e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Krujë dhe ka shfaqur vullnetin për t’u komanduar në pozicionin e Magjistratit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Në zbatim të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 54/4 Komisioni për Zhvillimin e Karrierës përgatit një projekt-opinion për çdo kandidat dhe vlerëson nëse komandimi nuk është në përputhje me interesat e larta të prokurorisë ku kandidati ushtron funksionin.

Sa më sipër, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka përgatitur opinionin ligjor pasi ka verifikuar, ekzistencën ose jo të ndonjë prej kriterëve ndaluese si dhe duke vlerësuar çënimin apo dëmtimin e funksionalitetit të prokurorisë ku ushtron detyrën prokurori që ka paraqitur kërkesën për komandim.

Në lidhje me kriteret ndaluese të komandimit, nga dokumentacioni i depozituar dhe dosja personale e prokurorit, rezulton se:

Prokuror Mirela Kapo ushtron funksionin e magjistratit që prej datës 02.11.2015, pasi me dekretin nr. 9299, datë 02.11.2015 të Presidentit të Republikës, është emëruar prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Krujë.

Nga dosja personale rezulton se nuk ka patur transferime si prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kruje, si dhe nuk ka patur pozicion Drejtuesi.

Ajo ka një eksperiencë profesionale në punë 5 (pesë) vjet, nuk ndodhet në një pozicion me mandat të kufizuar, si edhe ka qenë më parë e komanduar pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë nga data 22.02.2019 deri në datë 22.02.2020 dhe nuk ka masë disiplinore në fuqi. Në këto kushte për këtë prokuror nuk ekziston asnjë kriter ndalues komandimi.

Në lidhje me cenimin apo dëmtimin e funksionalitetit (interesit të lartë) të prokurorisë ku kandidati ushtron funksionin, nga informacioni e mendimi i marrë nga Drejtuesi i Prokurorisë ku është i caktuar, rezulton se:

- Nga kthim-përgjigja nr. 107 prot, datë 21.02.2020 e Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Krujë rezulton se nisur nga ngarkesa në punë e prokurorit Mirela Kapo, komandimi i saj pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, nuk dëmton interesat aktuale të Prokurorisë Krujë.

Në këto kushte, Komisioni për Zhvillimin e Karrierës vlerëson se komandimi i Magjistrates znj. Mirela Kapo pranë zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, nuk passjell cenim të interesave të larta të Prokurorisë Krujë dhe nuk çenohet funksionaliteti i saj.

Mbi sa më lart, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës i ka propozuar Këshillit të Lartë të Prokurorisë:

Vijimin e procedurave të komandimit për kandidaten prokurore znj. Mirela Kapo .

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

Datë: 24.02.2020